

VENDIM
Nr.849, datë 17.12.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.624, DATË 11.9.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËVE PARALELE TIRANË-VORË
NË SUPERSTRADËN TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.624, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronari Neritan Alo Hazizaj, si rrjedhojë e ndryshimit, me vendim gjyqësor, të klasifikimit të sipërfaqes së shpronësuar prej 3 927 m² nga tokë arë në tokë truall, të shpronësohet për diferencën e çmimit shtesë prej 2 500 lekësh/m². Vlera e përgjithshme shtesë e shpronësimit arrin shifrën prej 9 817 500 (nëntë milionë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Fondi prej 9 817 500 (nëntë milionë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

c) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.12.2004.”.

2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARIT QË SHPRONËSOHET PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËVE
PARALELE (KRAHU I DJATHTË) TIRANË-VORË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pas.	Truall			Shënime
					sip.e shpronësuar			
1	Neritan	Alo	Hazizaj	20/14	3927	2500	9817500	